



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 109 dt.29.07.1996

PER
NGRITJEN NE TIRANE TE PIKAVE TE REKLAMACIONIT KULTUROR,
ARTISTIK, SPORTIV DHE ME VLERA TE TJERA PUBLIKE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Kulturës, për vendosjen në Tiranë të reklamacionit artistik, kulturor, sportiv dhe atyre me vlera të tjera publike, me qëllim që të intensifikohet ndjeshëm kjo veprimtari e rëndësishme në Tiranë dhe me qëllim që të përmirësohen praktikat për këtë qëllim, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.45, pika.16 dhe neni.34, pikat.15 dhe 16,

VENDOSI

1. Të vendosen në Tiranë pika të reklamacionit kulturor, artistik, sportiv dhe atij me vlera të tjera publike.
2. Drejtoria e Financës të financojë 10 pika cilindrike të planifikuara nga Drejtoria e Kulturës me vlerën totale 499.750 lekë.
3. Drejtoria e Financës të përcaktoj kriteret e taksimit për përdoruesit e pikave të reklamacionit publik.
4. Drejtoria e Shërbimit Publik përcakton vendet e vendosjes, kushtet teknike të vendosjes, kushtet e mirëmbajtjes dhe

rifreskimit duke bashkëpunuar edhe me Seksionin e Transportit.

5. Drejtoria e Kulturës ndjek kriteret artistike dhe estetike të reklamacionit.
6. Për zbatimin e vendimit ngarkohen Drejtoritë e Shërbimeve Publike, të Financës dhe Kulturës pas autorizimit të Titullarit të Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA